



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

**PROJEKTI: "PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË SHËNDETËSISË"**

**FINANCUESI: BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

**Miraturar në :** 24 Mars 2015

**Hyrja në fuqi:** 28 Gusht 2015

**Data e përfundimit:** 28 Shkurt 2021

**Periudha e Zbatimit:** 28 Gusht 2015 - 28 Shkurt 2021

**Vlera dhe Lloji i financimit:** 32.1 Million Euro (HUA)

## PASQYRA PËRMBLEDHËSE

### 1. Përshkrim i Projektit dhe Komponentët

Objekti i projektit është që të kontribuojë në: (a) përmirësimin e efikasitetit të kujdesit në spitalet e përzgjedhura në territorin e Shqipërisë; (b) përmirësimin e menaxhimit të informacionit në sistemin shëndetësor; dhe (c) rritjen e aksesit financiar për shërbimeve shëndetësore.

Komponentët e projektit:

#### Komponenti 1. Përmirësimi i shërbimeve spitalore

- a. Realizimi i veprimtarive për të fuqizuar rrjetin spitalor duke përfshirë:
  - i. shqyrtimin dhe përditësimin e Master Planit Spitalor ekzistues;
    - ii. pilotimin në të paktën tre qarqe, zbatimin e Master Planit të rishikuar në spitalet që do të transformohen në mjedise diagnostikuese të kujdesit parësor;
    - iii. realizimin e një vlerësimi për manaxhimin aktual të Qendrës Spitalore Universitare dhe rekomandimin e përmirësimeve përkatëse;
    - iv. shqyrtimin e kuadrit regullator ligjor dhe administrativ të spitalit në funksion të rritjes së autonomisë dhe llogaridhënies në shërbimet spitalore dhe, nëse është e aplikueshme, rekomandimin e një përmirësimi të kuadrit të sipërpërmendur;
    - v. ngritjen e kapacitetit të ekipeve të manaxhimit të spitaleve, MSH-së, FSSH-së dhe agjencive të tjera mbikqyrëse shëndetësore në lidhje me planifikimin e shërbimit,

alokimin e burimeve, manaxhimin e performancës dhe monitorimin e zbatimit e kontraktimin;

- vi. përgatitjen e pikave të referencës/benchmarks dhe të indikatorëve për të profilizuar performancën spitalore të krahasueshme;
  - vii. përditësimin, zbatimin dhe monitorimin e udhëzimeve dhe standardeve klinike për referimet spitalore;
  - viii. pilotimin e mekanizmave të llogaridhënies sociale bazuar tek pacientët si p.sh. linjat telefonike falas dhe reagime nëpërmjet telefonave celularë për të rritur reagimet e pacientëve dhe për të reduktuar pagesat informale;
  - ix. zhvillimin e Llogarive Kombëtare Shëndetësore për të mbështetur punën analitike në lidhje me buxhetin në sektorin e shëndetësisë.
- b. rehabilitimin dhe/ose përmirësimin e infrastrukturës dhe pajisjeve mjekësore të spitaleve të përzgjedhura në bazë të Master Planit Spitalor; dhe
  - c. ngritjen e një Qendre Shëndetësore Kombëtare dhe zhvillimin e një strategjie për të mirëmbajtur pajisjet mjekësore në sektorin e shëndetit publik.

**Komponenti 2: Zgjerimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Shëndetësor/e- Health**

- a. Kryerja e veprimtarive për të përmirësuar saktësinë dhe zotërimin në kohë të informacionit klinik, financiar dhe administrativ brenda dhe ndërmjet spitaleve rajonale ku përfshihen:
  - i. zhvillimi i një Master Plani për SMIS dhe për veprimtaritë e e-Health, një fjalori për të dhënat shëndetësore dhe një model të të dhënave shëndetësore; dhe
  - ii. krijimin e një Qendre Kombëtare për Informacionin Shëndetësor (Qendra Kombëtare e Informacionit Shëndetësor; dhe të Regjistrave Bazë për SMIS).
- b. realizimin dhe zbatimin e një sistemi të informacionit spitalor në spitalet rajonale të përzgjedhura dhe kryerjen e trajnimit përkatës për punonjësit e spitaleve rajonale të sipërpërmendura;
- c. zbatimin e një Sistemi të ri Informacioni për Sigurimet Shëndetësore që FSSH të automatizojë përpunimin e kërkesave të sigurimit shëndetësor dhe të përmirësojë mbikqyrjen ndaj sistemit që realizon kujdesin shëndetësor; duke përfshirë këtu edhe trajnimin e punonjësve përkatës të FSSH.

**Komponenti 3: Përmirësimi i Sistemit të Financimit të Shëndetësisë**

- a. Kryerja e veprimtarive për të mbështetur reformat në sistemin e pagesave në kujdesin parësor dhe në atë spitalor duke përfshirë: fuqizimin e kapacitetit të FSDKSH për të mbledhur dhe shfrytëzuar të dhënat shëndetësore dhe futjen në përdorim të shumës vjetore për tu paguar nga siguruesi i shëndetit për mjekun për çdo person të siguruar.

- b. shuma vjetore për tu paguar nga siguruesi i shëndetit për mjekun për çdo person të siguruar për kujdesin parësor si dhe sistemin e pagesës për grupin e lidhur me diagnozat për spitalet.
- c. Hartimi dhe pilotimi i politikave farmaceutike të cilat reduktojnë koston dhe përmirësojnë aksesin ndaj barnave që mund të përballohen financiarisht.

Pjesa 4: Monitorimi, Vlerësimi dhe Menaxhimi i Projektit

Krijimin dhe rritjen e kapaciteteve të Njësisë së Koordinimit të Projektit për të realizuar veprimtaritë e projektit duke përfshirë:

- kryerjen e menaxhimit të deleguar si një palë e tretë, aktiviteteve Monitoruese dhe vlerësuese
- realizimin e anketimeve që lidhen me projektin, dhe
- zbatimin e një strategjie komunikimi për Reformat në Shëndetësi.